

**MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
PREFEKTURËN E QARKUT VLORË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Prefekturën e Qarkut Vlorë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.197, datë 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 952/7, datë 31.12.2014, i ka rekomanduar znj. Etiona Hoxha, Prefekt i Qarkut Vlorë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Janë bërë emërimet dhe largimet nga detyra të padrejta dhe të paargumentuara, pasi nuk ka propozim nga shefi i PMNZSH, veprime në kundërshtim me nenin 12, pika 4 e ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001 “*Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin*”, i ndryshuar. Si pasojë e moszbatimit të ligjit të gjithë punonjësit e larguar dhe që kanë hapur proces gjyqësor i kanë fituar ato.

1.1. Rekomandim: Prefekti i Qarkut Vlorë të argumentojë urdhrat e lirimit nga detyra të punonjësve të sektorit të PMNZSH-së, arsyeja e lirimit si dhe të plotësojë dokumentacionin konform kërkesave ligjore.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2014, në 4 raste, emërimi i punonjësve të PMNZSH është bërë mbi moshën 35 vjeç, si dhe mënyra e pranimit nuk është bërë me konkurrim, por vetëm me urdher emërimi në kundërshtim me nenin 10, pika 1, paragrafi “c” të ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001, i ndryshuar.

2.1. Rekomandim: Struktura menaxhuese e institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, për çdo rast të pranimit në detyrë, të respektohen të gjitha kriteret e përcaktuara me ligj për emërimin dhe mënyrën e pranimit në strukturën e PMNZSH. Për 4 rastet e emërimit në kundërshtim me kriteret e ligjit, të nxirret përgjegjësia dhe të merren masat për rivlerësimin e marrëdhënies së punës.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), për periudhën Janar 2012-Qershor 2014 nuk është caktuar një jurist dhe specialist gjeodet në përbërje të këtij komisioni, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*”.

3.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa, që të plotësojë strukturën e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) me jurist dhe specialist gjeodet.

Deri me datën 31.3.2015

4. Gjetje nga auditimi: Dokumentacionet dhe materialet hartografike të krijuara, nuk administroheshin në format elektronik, pasi në dispozicion të kësaj njësie nuk është vënë një skaner dhe mjetet e tjera të nevojshme për administrimin e këtij dokumentacioni, siç përcaktohet në VKM nr. 1, datë 27.3.2009 “*Për miratimin e rregullores për organizimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë*”.

4.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të Prefektit të Qarkut të marrë masa për vënien në dispozicion të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), mjetet

elektronike për mbarëvajtjen e punës të nevojshme për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave që gjenerohen nga të tretët, për të ofruar një shërbim sa më të mirë, cilësor dhe në kohë.

Deri me datën 31.3.2015

5. Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë Vlorë, nuk ka hartuar program vjetor të kontrollit dhe verifikimit të titujve të pronësisë, për ta shqyrtuar e miratuar më tej në Komisionin Qendror të Tokave. Gjithashtu nuk ka kryer analizë të realizimit të programit, veprime këto në kundërshtim me germa “B”, pika 1, kreu I e VKM nr. 1269, datë 17.9.2008.

5.1. Rekomandim: Drejtori i Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë Vlorë, të përgatisë programin vjetor të kontrollit dhe verifikimit të titujve të pronësisë, dhe ta paraqesë për shqyrtim e miratim në Komisionin Qendror të Tokave.

Deri me datë 31.3.2015

6. Gjetje nga auditimi: Nuk është hapur libër i veçantë dhe konkretisht dokumenti “Regjistër i Vendimeve”, në kundërshtim me paragrafin katër, pika 3, neni 14 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009.

6.1. Rekomandim: Prefekti i Qarkut Vlorë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e azhurnimeve dhe rakordimeve, si dhe mbajtjen e dokumentit “Regjistër i Vendimeve”.

Deri me datën 31.3.2015

7. Gjetje nga auditimi: Në procesverbalet e pjesëmarrjes në mbledhje të Komisionit Vendor, nuk dokumentohet shprehja e mendimit të secilit anëtar për praktikën me vendimmarrje, veprime këto në kundërshtim me shkronjën a, pikën 6 kreu III të Vendimit nr. 1269, datë 17.9.2008.

7.1. Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për çdo rast në procesverbalet e pjesëmarrjes në mbledhje, të dokumentojë shprehjen e mendimit të secilit anëtar të Komisionit, veçanërisht për praktikën me vendimmarrje.

Deri me datën 31.3.2015

8. Gjetje nga auditimi: Librat e tokës, librat e parcelave të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore dhe ish-Kooperativave Bujqësore, fotokopjet e hartave 1:5000, gjithsej 65 plansheta, nuk janë me firmën dhe vulën e institucionit dhe të pa inventarizuara nga, në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.01.1993 “Për arkivat”, Kreu III, neni 24.

8.1. Rekomandim: Komisioni Vendor të marrë masa e të nisë inventarizimin dhe marrjen në dorëzim me procesverbal të librave të tokës dhe librave të parcelave të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore dhe ish-Kooperativave Bujqësore, fotokopje të hartave 1:5000, 65 plansheta, etj.

Deri me datën 31.3.2015

9. Gjetje nga auditimi: Në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë Vlorë, dosjet e Vendimeve nr. 11, 01 dhe 18 respektivisht në datat 8.10.2012, 01.3.2013 dhe 5.3.2013 janë pa numër fletësh progresive dhe të pa inventarizuara plotësisht, në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.01.1993 “Për arkivat”, Kreu III, neni 24.

9.1. Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë Vlorë të nisë procedurën e inventarizimit të gjitha dosjeve, me numër fletësh progresiv, në çdo fletë dhe listë inventari të nënshkruar nga specialisti përkatës.

Deri me datën 31.3.2015

10. Gjetje nga auditimi: Në dosjet e vendimeve të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 11 datë 8.10.2012, nr. 01 datë 01.3.2013 dhe vendimit nr. 18 datë 5.3.2013, mungonin:

- kërkesa e Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Vlorë së bashku me kartelën shoqëruese;

- në një rast nuk ndodhet dhe nuk administrohet relacioni dhe projekt-vendimi përkatës i dorëzuar me gjithë dosjen e përgatitur drejtorit të Komisionit Vendor;

- në dy raste Komisioni Vendor nuk ka paraqitur për shqyrtim informacionin përmbledhës

për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara, dokumentacionin që ka lidhje me çështjen dhe propozimin përkatës.

Në kundërshtim me pikën 1, seksioni dytë, pikën 4 dhe pikën 6 të kreut III të Vendimit nr. 1269, datë 17.9.2008 dhe me nenet 4, 7, 8 dhe nenin 14 të Rregullores miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009.

10.1. Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa për të plotësuar dosjet me dokumentacionin e nevojshëm, sipas mangësive përkatëse.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Ambienti (godina) ku është vendosur Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, ndodhet në objekt me elementë të pakët sigurie. Dokumentet e një rëndësie të veçantë që shërbejnë për ruajtjen dhe administrimin e titujve të pronësisë administrohen dhe ruhen jashtë kushteve minimale të nevojshme, në ambiente me lagështi dhe të pa përshtatshme, pa dyer hekuri, pra jashtë kushteve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve, veprime në kundërshtim me Kreu III, neni 24 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003.

11.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë të marrë masa të menjëhershme, për garantimin e ambienteve të përshtatshme sipas standardeve, për ruajtjen dhe administrimin fizik e teknologjik të dokumenteve.

Deri me datën 31.3.2015

12. Gjetje nga auditimi: Nuk janë pajisur me leje qarkullimi 23 mjetet që ka në pronësi PMNZSH, për pasojë nuk janë paguar taksat, siguracioni i detyrueshëm dhe kontrolli teknik, në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor” i ndryshuar, nenet 79, 99 dhe 100 dhe me ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

12.1. Rekomandim: Për mjetet e PMNZSH të merren masa dhe të nisin procedurat për ti pajisur me leje qarkullimi, pagesën e taksave, siguracionin dhe kontrollin teknik.

Deri me datën 31.3.2015

13. Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit nuk ka marrë masa, për tu pajisur me çertifikata pronësie objektet dhe truallit që kanë në inventar, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ndryshimet.

13.1. Rekomandim: Prefekti Qarkut Vlorë të marrë masat e nevojshme, për regjistrimin e aseteve në ZVRPP Vlorë dhe pajisjes me dokumentin e pronësisë.

Deri me datën 31.3.2015

14. Gjetje nga auditimi: Për objektet në inventar nuk është përcaktuar çmimi i truallit (truall 1878 m² prej të cilave në Vlorë sipërfaqe truallit 1,533 m² dhe Sarandë 345 m²) në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, me ndryshime. Vlera e truallit nuk është pasqyruar në bilanc, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 26, kreu III-të Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

14.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të marrë masa dhe të ngrëjë grup pune për matjen në vend, të sipërfaqes “Truall dhe Objekt” dhe të bëhet inventarizimi i tyre në llogarinë përkatëse. Në bilancin kontabël të pasqyrohet në mënyrë analitike vlera e sipërfaqes për çdo objekt.

Deri me datën 31.3.2015

15. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka përfunduar manualin e ri specifik për t’ia dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditin e Brendshëm pranë MF dhe nuk janë hartuar Metodika të veçanta në zbatim të Manualit të Procedurave të Auditit të Brendshëm, parashikuar në pikën 1.3 “Hartimi i Metodikave të veçanta” të “Manualit të Auditimit të Brendshëm”.

15.1. Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm të përfundojë materialin për manualin e ri specifik dhe ta dërgojë atë pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, si dhe të hartojë metodika të veçanta në zbatim të Manualit të Procedurave të Auditit të Brendshëm.

16. Gjetje nga auditimi: Nuk janë planifikuar dhe dërguar në kurse kualifikimi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, specialistët dhe punonjësit e subjekteve të tyre. PMNZSH, nuk i është nënshtruar formimit dhe trajnimit në kurset pranë Shkollës së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe në Qendrën e Trajnimit të Emergjencave Civile, në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001, i ndryshuar.

16.1. Rekomandim: PMNZSH të zbatojë programe vjetore trajnimesh dhe të dërgojë punonjësit në kurse kualifikimi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, pranë Shkollës së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe në Qendrën e Trajnimit të Emergjencave Civile.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nuk është bërë studim në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, si dhe nuk ekziston bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore, projektuese e me organizma ndërkombëtare. Nuk është njoftuar rregullisht publiku për detyrat dhe masat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, etj, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, veprime këto që vijnë në kundërshtim me kreun VI nenin 33, pikat “c” dhe “e”, të ligjit nr. 8766 datë 5.4.2001, i ndryshuar.

17.1. Rekomandim: Në bashkëpunim me institucionet përkatëse të bëhen studime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Gjithashtu të njoftohet periodikisht publiku për detyrat dhe masat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, etj., si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste.

Deri me datën 31.3.2015

18. Gjetje nga auditimi: Mungon regjistri themelor i evidentimit të subjekteve që paguajnë çdo vit tarifën e akteve teknike në zbatim të VKM nr. 285, datë 27.6.2002 “Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj”.

18.1. Rekomandim: Njësia e parandalimit të PMNZSH të mbajë regjistrin themelor të evidentimit të subjekteve që paguajnë tarifën e akteve teknike çdo vit, për pikat e karburantit, mjeteve autobot, pikave të tregtimit të gazit dhe njësitë e tregtimit të bombolave.

Deri me datën 31.3.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2012 janë paguar orë shtesë në shumën **1.933.320** lekë, e cila përbën dëm ekonomik, pasi kjo pagesë është në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 511 datë 24.10.2002, i ndryshuar dhe pika 2, Udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2011 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 463 datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave”.

1.1. Rekomandim: Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 8.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **1.933.320 lekë** për 57 persona.

Deri me datën 31.3.2015

C. MASA DISIPLINORE

I - Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Vlorë, që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “*Largim nga Shërbimi Civil*”, për:

1. **Z. E.M.** me detyrë përgjegjës i zyrës së burimeve njerëzore, për:

Kryerjen e procedurave të emërimeve dhe largimeve nga detyra të punonjësve pa propozimin e shefit të PMNZH, në kundërshtim me nenin 12, pika 4 e ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” i ndryshuar.

- Për vitin 2014 në 4 raste, emërimi i tyre nuk është bërë sipas kriterëve të përcaktuara, ku punonjësit e rekrutuar duhet të jenë nën moshën 35 vjeç, në kundërshtim me nenin 10, pika 1, paragrafi c të ligjit nr. 8766 datë 5.4.2001.

- Punësimi i punonjësve të PMNZH nuk është bërë me konkurrim por vetëm me urdhër emërim, në kundërshtim me nenin 10, pika 1, e ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001, i ndryshuar.

II - Në zbatim të ligjit nr. 152/ 2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Vlorë, që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për:

1. Zj. E.K. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Administrimit Financiar, për:

- Dëmin ekonomik për pagesa ore shtesë në shumën **1.933.320 lekë**, në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 511 datë 24.10.2002, Udhëzimin nr. 16, datë 20.7.2011 pika 2 “Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011”.

2. A.D. me detyrë Drejtor i Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë prej mars 2014, për:

- Mos mbajtjen e librave të veçantë konkretisht “Regjistri i Vendimeve”, në kundërshtim me nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të Komisionit Qendror të Tokave.

- Mos hartimin e planeve mujore të punës së Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.

- Regjistri i mbajtur për korrespondencat nuk i shërben pasqyrimin të ndjekjes së ecurisë së trajtimit të kërkesës sipas stadeve, procedurave të ndjekura, që të sjellë pasqyrimin e qartë të afateve, dokumentacionit, rritjen e transparencës, llogaritjen e kapaciteteve dhe pasqyrimin e punës së KVVTP sipas periudhave, në plotësim të detyrimit të nenit 7, pika 1 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KVVTP”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT.

III - Në zbatim të kreut IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Vlorë, që për shkeljet e konstatuara, të fillojë procedura për marrjen e masave disiplinore:

“Vërejtje”, për:

1. M.S. (jurist) filluar punë më datë 01.4.2011, në vazhdim;

2. S.L. (juriste) filluar punë në shtator 2011, në vazhdim;

3. E.T. (juriste) filluar punë më datë 01.4.2012 e në vazhdim;

4. A.L. (inxhinieri ndërtimi) filluar punë në shtator 2012, në vazhdim;

5. R.B. (juriste) filluar punë në muajin mars 2013 e në vazhdim;

Për të metat dhe mangësitë e mëposhtme:

Në dosjet e vendimeve të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 11 datë 8.10.2012, nr. 01 datë 01.3.2013 dhe vendimit nr. 18 datë 5.3.2013, mungonin:

- kërkesa e Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Vlorë së bashku me kartelën shoqëruese;

- në një rast nuk ndodhet dhe nuk administrohet relacioni dhe projekt-vendimi përkatës i dorëzuar me gjithë dosjen e përgatitur drejtorit të Komisionit Vendor;

- në dy raste Komisioni Vendor nuk ka paraqitur për shqyrtim informacionin përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara, dokumentacionin që ka lidhje me çështjen dhe propozimin përkatës.

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1, seksioni dytë, pikën 4 dhe pikën 6 të kreut III të Vendimit nr. 1269, datë 17.9.2008 dhe me nenet 4, 7, 8 dhe nenin 14 të Rregullores miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009.

Shënim:

Për punonjësit që nuk janë më në marrëdhënie pune, nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “*Vërejtje me shkrim*” dhe përkatësisht për:

1. **L.Y.** (juriste) larguar nga detyra mars 2013.
2. **G.H.** ish- i KV, larguar më 27.2.2014.
3. **T.V.** (agronom) filluar punë në shtator 2011, larguar më 18.03.2013.
4. **I.H.** me detyrë (inxhinier) larguar nga detyra më datë 3.9.2012.
5. **E. P.** marrë detyrën në vitin 2011, larguar nga detyra në qershor 2014.

Për ish-punonjësit Prefekti i Qarkut Vlorë të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Jonild Hoxhaj, Dorino Mece, Genc Koka dhe Sotir Kosdine më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT